



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRIZREN

---

Numri i lëndës: 2019:250840

Datë: 08.11.2019

Numri i dokumentit: 00636203

**P.nr.1441/19**

**NË EMËR TË POPULLIT**

**GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN** – Departamenti i Përgjithshëm, gjyqtari Fidan Hoxha, me sekretaren juridike Ardijana Reshtani, në çështjen penale ndaj të akuzuarit S. M. nga ... Komuna e Klinës, për shkak të veprës penale Vjedhje nga neni 313 par.1 të KPRK-së, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Prizren – Departamenti i Përgjithshëm, nën numrin PP/II.nr.2416-8/19 të datës 30.10.2019, pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar, në prezencën e prokurorit të shtetit Ramadan Koro, i akuzuari S.M. dhe mbrojtësi i tij Av. B.K., me datë 31.10.2019 publikisht mori dhe shpalli, ndërsa me datë 08.11.2019 përpiloi këtë:

**A K T G J Y K I M**

**I akuzuari:**

**S.M.**, nga i ati B. dhe e ëma Xh.e lindur A., lindur më datë 24.05.1956 në Prizren, me banim në fshatin ... Komuna e Klinës, i martuar, baba i gjashte fëmijëve, ka të kryer shkollën e mesme, me profesion automekanik, i gjendjes së dobët ekonomike, me numër personal 1008970501, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës.

**ËSHTË FAJTOR**

Se me datë 16.10.2019, rreth orës 13:25, në Prizren, në “Abi Center”, saktësisht në barnatoren “...”, i pandehuri me qëllim të përvetësimit të kundërligjshëm të pasurisë për vete, në dëm të dëmtuarës A. V., shfrytëzon momentin e volitshëm deri sa e dëmtuara i lë syzet në banak të barnatores dhe e shikon për të blerë barna dhe bisedon me shitësen në atë vend, i pandehuri i ofrohet banakut, ku fillimisht e nxjerr portofolin nga xhepi dhe në mënyre tinxare arrin që ti merr syzet nga aty dhe menjëherë largohet nga aty dhe shkon në drejtim të panjohur, me ç’ rast të dëmtuarës i shkakton dëm material në shumë prej 250 euro.

Me këto veprime ka kryer veprën penale Vjedhja nga neni 313 par.1 të KPRK-së.

Gjykata në bazë të nenit 7, 8, 9, 10, 43, 48, 69, 70 dhe nenit 313 par.1 të KPRK-së si dhe nenit 365 të KPPRK-së, të akuzuarit i shqipton dënimin dhe atë:

## **DËNIM ME GJOBË**

Në shumën prej 200 (dyqind) euro, të cilin dënim i akuzuari duhet ta paguaj në afat prej dy (2) muajve, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Në rast se i pandehuri dënimin me gjobë nuk dëshiron ose nuk mund të paguaj, gjykata dënimin me gjobe do ta zëvendësojë në dënim me burg, konform nenit 43 par.3 të KPRK-së dhe

## **DËNIM ME KUSHT**

Dënimin me burgim në kohëzgjatje prej 3 (tre) muaj, i cili dënim nuk do të ekzekutohet në afat prej 1 (një) viti nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nëse i akuzuari nuk kryen veprë të re penale.

Ndërsa koha e kaluar në ndalim, nga data 29.10.2019 deri më 31.10.2019, do të llogaritet nëse dënimi me kusht do të revokohet në dënim me burgim.

E dëmtuara A. V. nga Prizreni, rr. "... " nr.1... për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohen në kontest të rregullt civil.

Obligohet i akuzuari që ti paguaj shpenzimet e procedurës penale sipas llogarisë së gjykatës, paushallin gjyqësor të paguaj shumën prej 20 euro, si dhe në emër të fondit për kompensimin e viktimave të krimit ta paguaj shumën prej 30 euro, në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi nën kërcënim të ekzekutimit të dhunshëm.

## **A r s y e t i m**

Prokuroria Themelore në Prizren – Departamenti i Përgjithshëm, ka parashtruar aktakuzë nën numrin PP/II.nr.2416-8/19 të datës 30.10.2019, ndaj të akuzuarit S.M. nga fshati ... Komuna e Klinës, për shkak të veprës penale Vjedhje nga neni 313 par.1 të KPRK-së.

Gjykata në këtë çështje penale e ka caktuar shqyrtimin fillestar në të cilin i akuzuari pasi që është deklaruar lidhur me aktakuzën e Prokurorisë Themelore në Prizren PP/II.nr.2416-8/19 të datës 30.10.2019, ka pranuar fajësinë për veprën penale për të cilën akuzohet sipas kësaj aktakuze.

Gjykata nga pranimi i fajësisë nga ana e të akuzuarit dhe provave materiale nga shkresat e lëndës, ka vërtetuar këtë gjendje faktike: se me datë 16.10.2019, rreth orës 13:25, në Prizren, në "Abi Center", saktësisht në barnatoren "...", i pandehuri me qëllim të përvetësimit të kundërligjshëm të pasurisë për vete, në dëm të dëmtuarës A.V., shfrytëzon momentin e volitshëm deri sa e dëmtuara i lë syzet në banak të barnatores dhe e shikon për të blerë barna dhe bisedon me shitësen në atë vend, i pandehuri i ofrohet banakut, ku fillimisht e nxjerr portofolin nga xhepi dhe në mënyrë tinxare arrin që ti merr syzet nga aty dhe menjëherë largohet nga aty dhe shkon në drejtim të panjohur, me ç'rast të dëmtuarës i shkakton dëm material në shumë prej 250 euro.

Gjykata gjendjen e këtillë faktike e ka vërtetuar nga vet pranimit i fajësisë nga ana e të akuzuarit S.M. në shqyrtimin fillestar, vullnetarisht e ka pranuar fajësinë, për veprën penale për të cilën akuzohet. Gjykata sipas detyrës zyrtare nuk ka gjetur se ekziston ndonjë provë e pa pranueshme, po ashtu në tërësi është vërtetuar se i akuzuari, ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajësisë për veprën penale e cila i vihet në barrë, dhe ky pranim është bërë pa kushtëzim dhe vullnetarisht nga ana e tij, se pranimit i fajësisë mbështet në fakte dhe prova të çështjes që përmban aktakuza, dhe se aktakuza nuk përmban asnjë shkelje të qartë ligjore ose gabime faktike.

Gjykata nga të cekurat më lartë ka ardhur në përfundim se në veprimet e të akuzuarit formohen të gjitha elementet e qenies së veprës penale të përshkruara si në shqiptim të këtij aktgjykimi dhe për këtë ka vendosur që i akuzuari të shpallet fajtor dhe ta gjykoj në bazë të ligjit, e më parë duke vërtetuar përgjegjësinë penale juridike të tij.

Gjatë marrjes së vendimit mbi llojin dhe lartësinë e dënimit, gjykata ka vlerësuar të gjitha rrethanat lehtësuese dhe rënduese të parapara si në nenin 69 dhe 70 të KPRK-së, të cilat ndikojnë në zgjedhjen e llojit dhe lartësisë së dënimit. Si rrethana lehtësuese për të akuzuarit gjykata ka vlerësuar pranimin e fajësisë nga ana e tij, sjelljen korrekte në gjykatë, pendimin pas kryerjes së veprës penale. Kështu që duke mos gjetur rrethana rënduese gjykata ka ardhur në përfundim se me dënimin e shqiptuar do të arrihet efekti dhe qëllimi i dënimit dhe se me këtë dënim të tillë të shqiptuar sipas bindjes së gjykatës janë në proporcion me veprën penale të kryer dhe me rrethanat personale të cilat i posedon i akuzuari dhe se në të ardhmen dënimi i tillë i shqiptuar do të parandalojë kryerësin nga kryerja e veprave penale.

Vendimi mbi udhëzimin e dëmtuarës në kontest të rregullt civil për realizimin e kërkesës pasurore juridike, është marrë konform nenit 463 par.1 e 2 të Kodit të Procedurës Penale të Republikës së Kosovës.

Vendimin mbi shpenzimet e procedurës penale është marrë në pajtim me nenin 453 par.1 të KPPRK.

Vendimi mbi taksën gjyqësore në emër të kompensimit e të viktimave të krimit, është marrë në pajtim me neni 39 par.3 nën par.3.1 të Ligjit për Kompensimin e Viktimave të Krimit Nr.05/L-036.

Nga të cekurat më lartë u vendos si në shqiptim të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE PRIZREN  
DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM , DIVIZIONI PENAL**

**2019:250840, 08.11.2019**

**G j y q t a r i**

Fidan Hoxha

**KËSHILLË JURIDIKE:** Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga koha e pranimit të të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, nëpërmjet kësaj Gjykate Themelore.